

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **“Adi Professional” sh.p.k** me Nr.Nipti: **K22113002I** me adresë: Tiranë, KASHAR Njesia administrative Kashar, Rruga Butrinti nr.9.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”, prokurim me mjete elektronike – Mallra me numër **REF-54842-03-24-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje Bileta Elektronike për Parkim”**

Fondi limit 7,312,833 (shtatë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**

Burimi i Financimit : Buxheti i Tirana Parking, miratuar me V.K.B. Nr.157 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 7 (shtatë) ditë duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **21.04.2020, ora 12:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

1.Operatori ekonomik “Adi Proffesional” sh.p.k

K22113002I

Çmimi total i ofertës është **7,232,500** (shtatë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) **Lekë pa TVSH**

2.Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k

L51819005Q

Çmimi total i ofertës është **6,412,500** (gjashtë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind)

Lekë pa TVSH

3.Operatori ekonomik "AICOM" sh.p.k

L51714014K

Çmimi total i ofertës është **6,330,000** (gjashtë milion e treqind e tridhjetë mijë) **Lekë pa TVSH**

4.Operatori ekonomik "Adel CO" sh.p.k

L22117021M

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Njoftojmë se, ofertat e mëposhtme janë cilësuar si të pavlefshme për arsyet si vijon:

Oferta e paraqitur nga Shoqëria: **"AICOM"sh.p.k**

Çmimi total i ofertës është **6,330,000** (gjashtë milion e treqind e tridhjetë mijë) **Lekë pa TVSH**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik te ofertës së ofertuar në këtë procedure prokurimi rezulton se:

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu VII neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

1.Nuk i plotëson kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit për arsyet e mëposhtme :

Te kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit shprehet qartë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit . Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurese, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse"

Ndërkohë që Sipas ekstraktit të QKB Operatori Ekonomik nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij mallin (Biletat Elektronike) e kërkuar për tu prokuruar nga Autoriteti kontraktor Tirana Parking.

2.Nuk plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST për arsyet e mëposhtme :

2.1Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a)Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron e tre viteve të fundit 2016, 2017 dhe 2018 ku mesatarja vjetore duhet të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit të kësaj procedurë prokurimi.

b)OE ka paraqitur xhiron vjetore vetëm për vitet 2017, 2018, ndërkohë që nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitin 2016 sipas kriterëve te veçanta në DST.

3. Për kapacitetin teknik:

Operatori ekonomik duhet te paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit, me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Dëshmitë për fumizimet e mëparshrne të paraqitura nga Operatori Ekonomik nuk janë të ngjashme

me objektin e prokurimit.

3.1 Për kapacitetin teknik:

a) Operatorët pjesëmarrës duhet paraqesin dorazi ditën dhe orën e hapjes së ofertave një monstër (5000 copë) të kutisë dhe të biletave fanfold të parkimit elektronik, si dhe master të tipit rulon në përputhje me të gjitha specifikimet teknike në DST. Mos paraqitja përbën kusht s'kualifikimi.

b) Operatori ekonomik ka paraqitur ditën e hapjes së ofertave pranë institucionit Tirana Parking mostrat e kërkuara sipas Kriteve të veçanta të DST nga Autoriteti Kontraktor Tirana Parking. Nga verifikimi KVO për mostrat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik, u konstatua se:

- Ambalazhimi i kutisë së biletave "fanfold" nuk përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

- Kutia e biletave "fanfold" nuk përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi vihet re që nuk është prodhuar nga makineri e posaçme prodhimi por e prerë dhe assembluar manualisht.

- Sasia e kërkuar e biletave elektronike (5000 copë) nuk është paraqitur nga Operatori Ekonomik. Ky i fundit ka futur në kutinë e biletave sasinë prej 240 biletash dhe ka mbushur pjesën tjetër të kutisë me letra standarte A4.

4. Nuk i plotëson kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit për arsyet e mëposhtme : Te kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit shprehet qartë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit . Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurese, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse"

Ndërkohë që Sipas ekstraktit të QKB Operatori Ekonomik nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij mallin (Biletat Elektronike) e kërkuar për tu prokuruar nga Autoriteti kontraktor Tirana Parking.

4.1 Nuk plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST për arsyet e mëposhtme :

Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a) Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron e tre viteve të fundit 2016, 2017 dhe 2018 ku mesatarja vjetore duhet të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit të kësaj procedure prokurimi.

b) OE ka paraqitur xhiron vjetore vetëm për vitet 2017, 2018, ndërkohë që nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitin 2016 sipas kriteve të veçanta në DST.

5. Për kapacitetin teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit, me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që preokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit .

- Dëshmitë për furnizimet e mëparshme të paraqitura nga Operatori Ekonomik nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

6. Për kapacitetin teknik:

Operatorët pjesëmarrës duhet paraqesin dorazi ditën dhe orën e hapjes së ofertave një monstër (5000 copë) të kutisë dhe të biletave fanfold të parkimit elektronik, si dhe mostër të tipit rulon në përputhje me të gjitha specifikimet teknike në DST. Mos paraqitja përbën kusht s'kualifikimi.

- Operatori ekonomik ka paraqitur ditën e hapjes së ofertave pranë institucionit Tirana Parking mostrat e kërkuara sipas Kriteve të veçanta të DST nga Autoriteti Kontraktor Tirana Parking. Nga verifikimi i KVO për mostrat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik, u konstatua se:

- Ambalazhimi i kutisë së biletave "fanfold" nuk përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

- Kutia e biletave "fanfold" nuk përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi vihet re

qe nuk është prodhuar nga makineri e posaçme prodhimi por e prerë dhe assembluar manualisht.

•Sasia e kërkuar e biletave elektronike (5000 copë) nuk është paraqitur nga Operatori Ekonomik. Ky i fundit ka futur në rutinë e biletave sasinë prej 240 biletash dhe ka mbushur pjesën tjetër të kutisë me letra standarte A4.

7. Per kapacitetin teknik:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001 për "Menaxhimin e cilësisë"

•Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001 për menaxhimin e cilësisë. Çertifikata e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të Autoritetit Kontraktor

Per sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazuar në Nenin 46, pika 1 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

në mbështetje të **Nenit 53 pika 3** te Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet që: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”;

si dhe referuar **Nenit 53 pika 5 gërma c)** te Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) ku përcaktohet që: “Autoriteti Kontraktor **nuk e pranon nje oferte: c) kur oferta e tij nuk perputhet mespecifikimet e percktuara ne dokumentat e tenderit”, vendosi se dokumentacioni i paraqitur prej këtij operatori ekonomik nuk rezulton të plotësojë të gjitha kriteret, dhe oferta e paraqitur prej tij nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta **nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit referuar listës se kërkesave të tenderit të shpallur në sistemin elektronik të APP në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914 , datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) kreu VII neni 66, pika 3.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik" si dhe dokumentave të tenderit të miratuara , u konstatua se oferta e operatorit ekonomik "**AICOM**" **sh.p.k** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.

2.Oferta e paraqitur nga Shoqëria: “ALBDESIGN PSP”sh.p.k

Çmimi total i ofertës është **6,412,500** (gjashtë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) **Lekë pa TVSH**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik te ofertës së ofertuar në këtë procedure prokurimi rezulton se:

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

- I ploteson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Nuk i ploteson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST, konkretisht:

2.1 Per kapacitetin teknik:

Operatorët pjesëmarrës duhet paraqesin dorazi ditën dhe orën e hapjes së ofertave një mostër (5000 copë) të kutisë dhe të biletave fanfold të parkimit elektronike si dhe mostër të tipit rulon në përputhje me të gjitha specifikimet teknike në DST. Mos paraqitja përbën kusht s'kualifikimi.

• Mostra e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor e tipit rulon me kapacitet gjenerues prej rreth 6000 (gjashtëmijë) bileta nuk është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST. Nga kontrolli i layer i mostrës në fjalë u konstatua se trashësia (spesori) i biletave rulon ishte më i hollë se biletat aktuale për sistemet e parkimit që përdorin këtë lloj bilete. Nga testimi i mostrës në makinerinë gjeneruese të biletave u vu re se:

• Pjesa termike e cila digjet gjatë procesimit të biletës është në faqen e brendshme të rullit, pra është në anën e kundërt të printimit të biletës. Kjo bënë që rulli të mos insertohet në mënyrën e duhur në mekanizmin mbajtes se biletave duke bërë që biletat të mos printohen në makineri dhe të ngecin në porten e daljes së makinerisë.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazuar në Nenin 46, pika 1 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;**

në mbështetje të **Nenit 53 pika 3** të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet që: “**Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji**”;

si dhe referuar **Nenit 53 pika 5 gërma c)** të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) ku përcaktohet që: “**Autoriteti Kontraktor nuk e pranon nje oferte: c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit**”, vendosi se **dokumentacioni i paraqitur prej këtij operatori ekonomik nuk rezulton të plotësojë të gjitha kriteret, dhe oferta e paraqitur prej tij nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se oferta **nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit referuar listës së kërkesave të tenderit të shpallur në sistemin elektronik të APP në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) kreu VII neni 66, pika 3.

Mostra e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor nuk rezulton të plotësojë kriteret e kerkuara në DST dhe oferta e paraqitur prej tij nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit

Nga shqyrtimi i kesaj oferte ne mbeshtetje me nenin 53 te Ligjit 9643, date 20. 11.2006, për "Prokurimin publik" si dhe dokumentave të tenderit të miratuara , u konstatua se oferta e operatorit ekonomik "ALBDESIGN PSP " sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.

3."Adel CO "sh.p.k

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Operatori Ekonomik ka ngarkuar ne SPE vetëm dokumentat si më poshtë:

1. Ekstrakt i thjeshtë në QKB
2. Formulari i Ofertës Ekonomike (i paplotësuar)
3. Vërtetimi për shlyrejen e detyrimeve për taksat vendore.

Mungon pjesa tjetër e dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontrator.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazuar në Nenin 46, pika 1 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

në mbështetje të **Nenit 53 pika 3** të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet që: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”;

si dhe referuar **Nenit 53 pika 5 gërma c)** të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) ku përcaktohet që: “Autoriteti Kontraktor **nuk** e pranon nje oferte: c) kur oferta e tij **nuk** përputhet mespecifikimet e percktuara ne dokumentat e tenderit”, vendosi se dokumentacioni i paraqitur prej këtij operatori ekonomik nuk rezulton të plotësojë të gjitha kriteret, dhe oferta e paraqitur prej tij nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se oferta **nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit referuar listës së kërkesave të tenderit të shpallur në sistemin elektronik të APP në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) kreu VII neni 66, pika 3.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, date 20.11.2006, per "Prokurimin publik" si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik "**Adel CO " sh.p.k** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.

Njoftojmë se, është cilësuar si e vlefshme oferta e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga Shoqëria: “**Adi Proffesional**”sh.p.k

Çmimi total i ofertës është **7,232,500** (shtatë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind)
Lekë pa TVSH

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT.
- Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, date 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu VII neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **"Adi Professional" sh.p.k** është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si ofertë të vlefshme.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 56 të Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me të gjitha ndryshimet, VKM Nr.914 dt 29.12.2014 Kreu VII, Neni 66, pika 5 vlerëson në bazë të formulës së parashikuar në dokumentat e tenderit nëse oferta është apo jo anomalisht e ulët.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në kreun VII neni 66, pika 5 të RrPP. Nga shqyrtimi që ju është bërë dokumentacionit të operatoreve ekonomik të paraqitur rezultoi 1 (një) ofertë e vlefshme dhe rrjedhimisht përdoret formula e mëposhtme:

"Në rastin kur Janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur me shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur.

Operatori ekonomik **"Adi Professional" sh.p.k**

Ka paraqitur oferta ekonomike në sbumen prej **7,232,500** (shtatë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) **Leke pa TVSH**

Fondi limit = është **7,312,833** (shtatë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e teteqind e tridhjetë e tre) **Lekë pa TVSH**

"Adi Professional" sh.p.k me ofertë ekonomike prej **7,232,500** (shtatë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) **Lekë pa TVSH**

75% i Fondit Limit = $75\% \times 7,312,833 = 5,484,625$ (pese milion e katerqind e tetedhjetë e kater mijë e gjashtëqind e njetzet e pese) **Leke pa TVSH.**

Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e **"Adi Professional" sh.p.k** nuk është anomalisht e ulët.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të hollësishëm të veprimeve të kryera, gjatë procedurës së prokurimit, duke u ballafaquar me dokumentat e tenderit, si dhe detyrimet ligjore për prokurimet publike, është arritur në konkluzionin, se oferta e paraqitur dhe e dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik nga operatori ekonomik, është e pranueshme dhe e vlefshme të kualifikohet, mbasi është në përputhje me kërkesat e ligjit të prokurimeve, plotëson kërkesat administrativo-ligjore dhe specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit të Autoritetit tonë Kontraktor. **Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e paraqitur e vlefshme nuk është anomalisht e ulët** në bazë të nenit 56 të Ligjit 9643 datë.20.11.2006 "Për Prokurimet Publike".

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **"Adi Professional" sh.p.k** me Nr.Nipti: **K22113002I** me adresë: Tiranë, KASHAR Njesia administrative Kashar, Rruga Butrinti nr.9 me ofertë është **7,232,500** (shtatë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) **Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Tirana Parking, me adresë: Rruga "Ali Begeja", Nd.16, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit

të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në pikën 5, Neni 58 të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.04.2020.

Ankesa: Po

Ka marrë përgjigje në datë: 07.05.2020.

Duke ju referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) Nr.417/1Pro, datë 15.05.2020, nga AK Tirana Parking është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit me objekt: **"Blerje Bileta Elektronike për Parkim"** me shkresë Nr.573/9Prot, datë 30.04.2020 "Vendim pezullimi"

Gjithashtu bazuar Vendimit Nr 223/1Prot, datë 29.06.2020, të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), nga AK Tirana Parking është hequr nga pezullimi procedura e prokurimit me shkresën "Vendim Heqje Pezullimi" Nr144. Nr573/16Prot, datë 30.06.2020 dhe në vijim është vazhduar me Njoftim Fituesi.